



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.qpz.gov.al

Nr.25

19 mars

2010

P Ë R M B A J T J A

	Faqe
Vendim i KM nr.106, datë 26.2.2010	Për lejimin e kalimit tranzit të një autokolone ushtarake sllovene, përmes territorit të Republikës së Shqipërisë 767
Vendim i KM nr.107, datë 10.2.2010	Për botimin, shtypjen, shpërndarjen dhe shitjen e teksteve shkollore të sistemit të arsimit parauniversitar 767
Vendim i KM nr.108, datë 17.2.2010	Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim të komunës Kurjan të qarkut të Fierit 769
Vendim i KM nr.109, datë 17.2.2010	Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të komunës Nikël të qarkut të Durrësit 770
Vendim i KM nr.111, datë 17.2.2010	Për miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të komunës Rrajcë të qarkut të Elbasanit 771
Vendim i KM nr.112, datë 17.2.2010	Për disa ndryshime në vendimin nr.112, datë 21.2.2007 të Këshillit të Ministrave “Për krijimin e Fondit Shqiptar të Konkurrueshmërisë” 772
Vendim i KM nr.113, datë 24.2.2010	Për miratimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë, për bashkëpunimin financiar për kalimin e fondit nga “Projekti Kruja II” në projektin “Programi për mbrojtjen e mjedisit të liqenit të Ohrit- Shkarkimi i ujërave të zeza në Pogradec II” 772
Vendim i KM nr.124, datë 17.2.2010	Për hapjen e programeve të studimit të ciklit të parë në universitetin “Ismail Qemali”, Vlorë 774

Vendim i KM nr.126, datë 17.2.2010	Për përcaktimin e strukturës së komisionit të shqyrtimit të aplikimit, të kriterëve, të dokumentacionit e të kushteve, që duhet të plotësojë aplikanti, për t'u pajisur me licencë për kazino, si dhe të rasteve të revokimit apo të pezullimit të kësaj licence	774
Vendim i KM nr.131, datë 24.2.2010	Për kalimin në pronësi, pa shpërblim, të një prone, misionit të bamirësisë “Motrat e Nënë Terezës”	780
Vendim i KM nr.133, datë 24.2.2010	Për krijimin e Task-Forcës për kërkimin, gjetjen dhe identifikimin e personave të ekzekutuar gjatë viteve të regjimit komunist	782
Vendim i KM nr.135, datë 3.2.2010	Për përcaktimin e kriterëve për ndarjen e Fondit për Zhvillimin e Rajoneve	783
Udhëzim i KM nr.4, datë 17.2.2010	Për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin nr.1, datë 13.6.2000 të Këshillit të Ministrave “Për strukturën e renditjes së punëve në shërbimin civil, metodologjinë përkatëse dhe përshkrimin përgjithësues të rolit të sekretarit të përgjithshëm në këtë shërbim”, të ndryshuar	784
Udhëzim i MF nr.8, datë 2.3.2010	Për disa shtesa e ndryshime në udhëzimin nr.26, datë 16.4.2009 “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore”	785
Vendim i KNSH nr.32, datë 15.2.2010	Për miratimin e udhëzimit “Për ndihmën shtetërore për mbrojtjen e mjedisit”	786
Vendim i KNSH nr.33, datë 15.2.2010	Për skemën ekzistuese të subvencionimit të hekurudhave	792
Vendim i ERE nr.16, datë 25.2.2010	Për miratimin e raportit vjetor të ERE-s “Gjendja e sektorit të energjisë dhe veprimtaria e ERE-s gjatë vitit 2009”	793
Vendim i ERE nr.17, datë 25.2.2010	Për fillimin e procedurave të rishikimit të rregullores së procedurave të certifikimit të prodhimit të energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme	794
Vendim i ERE nr.18, datë 26.2.2010	Për fillimin e procedurave për licencimin e shoqërisë “Dosku-Energy” sh.p.k	794

VENDIM
Nr.106, datë 26.2.2010

**PËR LEJIMIN E KALIMIT TRANZIT TË NJË AUTOKOLONE USHTARAKE SLOVENE,
PËRMES TERRITORIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 16 pika 2, 17, 18 e 19 të ligjit nr.9363, datë 24.3.2005 “Për mënyrën dhe procedurat e vendosjes dhe kalimit të forcave ushtarake të huaja në territorin e Republikës së Shqipërisë, si dhe për dërgimin e forcave ushtarake shqiptare jashtë vendit”, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lejimin e kalimit tranzit, përmes territorit të Republikës së Shqipërisë, në datën 26 shkurt 2010, në itinerarin porti i Durrësit-Qafë-Thanë të 1 (një) autokolone ushtarake slovene, të përbërë nga 2 (dy) automjete dhe 4 (katër) trupa të armatosur.

2. Pika e hyrjes në territorin e Republikës së Shqipërisë për autokolonën ushtarake slovene, të jetë porti i Durrësit dhe pika e daljes të jetë pika e kalimit të kufirit Qafë-Thanë.

3. Autokolona ushtarake slovene, gjatë hyrjes, lëvizjes dhe daljes në/nga territori i Republikës së Shqipërisë, të shoqërohet nga njësi të armatosura të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë.

4. Ngarkohet Ministria e Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.107, datë 10.2.2010

**PËR BOTIMIN, SHTYPJEN, SHPËRNDARJEN DHE SHITJEN E TEKSTEVE SHKOLLORE
TË SISTEMIT TË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 9, 56 e 63 të ligjit nr.7952, datë 21.6.1995 “Për arsimin parauniversitar”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, me propozim të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ministria e Arsimit dhe Shkencës miraton dhe certifikon tekstet shkollore të arsimit parauniversitar, të cilat konkurrojnë, në barazi të plotë, në përzgjedhje nga përdoruesit. Kriteret dhe procedurat e konkurrimit e të përzgjedhjes përcaktohen me udhëzim të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës.

2. Procesi i botimit, shtypjes, shpërndarjes dhe shitjes së teksteve shkollore të arsimit parauniversitar bëhet nga shtëpitë botuese. Shtëpitë botuese, të cilat marrin përsipër ta kryejnë këtë proces, paraqesin tekstet, për miratim, në bazë të kriterëve dhe procedurave të parashikuara në udhëzimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës. Shpenzimet për tekstet shkollore të dërguara në shkollë ose DAR/ZA, për të konkurruar në përzgjedhjen e tyre, përballohen nga shtëpia botuese.

3. Tekstet shkollore shpërndahen/shiten në mjediset shkollore. Drejtoritë e shkollave ofrojnë një ose dy mjedise shkollore, që përdoren nga të gjitha shtëpitë botuese, që lëvrojnë tekste në shkollën në fjalë.

4. Çmimi i shitjes është ai i vendosur në kopertinën e tekstit shkollor të certifikuar. Çmimet e teksteve shkollore, të miratuara nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës, indeksohen çdo vit, në përputhje me rritjen e inflacionit, të publikuar nga INSTAT.

5. Tekstet duhet të jenë të pajisura me pullën me hologramë, të certifikimit, të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës.

Pulla me hologramë u shitet botuesve nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës, kundrejt pagesës. Tekstet, që tregtohen pa këtë pullë, i nënshtrohen procesit të konfiskimit, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

6. Kategoritë që do të përfitojnë mbështetje buxhetore për kompensimin e çmimit të teksteve shkollore, janë si më poshtë vijon:

6.1 për nxënësit në arsimin parauniversitar që:

a) gëzojnë statusin ligjor të jetimit;

b) vijnë nga familje të cilat trajtohen me ndihmë ekonomike dhe pagesë papunësie nga zyrat e punësimit;

c) vijnë nga familje që kanë në përbërjen e tyre anëtarë me aftësi të kufizuara, të lindur ose të bërë të tillë, të cilët deklarohen të paafte për punë me vendim të KMCAP-së, sipas pikës 3 të nenit 7 të ligjit nr.9355, datë 10.3.2005 “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”, të ndryshuar, kur personi me aftësi të kufizuara është kryefamiljar dhe nuk ka anëtarë të familjes të punësuar në sektorin publik ose të vetëpunësuar në sektorin privat;

ç) vijnë nga familje ku kryefamiljari përfiton pension invaliditeti shteti dhe nuk ka anëtarë të familjes të punësuar në sektorin publik ose të vetëpunësuar në sektorin privat;

d) vijnë nga familje ku kryefamiljari përfiton pension pleqërie shteti dhe kanë fëmijë në ngarkim, të cilët janë pa të ardhura.

Çmimi i blerjes së teksteve shkollore mbulohet nga buxheti i Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës në formën e “Transferts tek individët”, në masën 100 për qind të tij.

6.2 Për nxënësit në arsimin 9-vjeçar, që vijnë nga familje ku kryefamiljari është i punësuar në institucionet publike buxhetore dhe jobuxhetore të pushtetit qendror apo vendor, si dhe në shoqëritë me kapital shtetëror, me pagë mujore bruto deri 30 000 (tridhjetë mijë) lekë në muaj dhe nuk ka anëtarë të familjes të punësuar në sektorin publik ose të vetëpunësuar në sektorin privat, çmimi i blerjes së teksteve shkollore mbulohet nga buxheti i vetë institucionit apo shoqërisë, në masën 50 për qind të tij.

6.3 Këshilli i Ministrave u rekomandon të gjithë punëdhënësve privatë të mbështesin financiarisht kompensimin e teksteve shkollore për të gjithë punëmarrësit e tyre, që kanë fëmijë në arsimin parauniversitar dhe që përfitojnë pagë mesatare mujore deri në 30 000 (tridhjetë mijë) lekë në muaj. Kjo pagesë njihet si shpenzim i veprimtarisë për efekte fiskale.

6.4 Për tekstet shkollore të nxënësve të pakicave kombëtare, nga klasa I deri IX, çmimi i blerjes do të mbulohet në masën 100 për qind me fondet e Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës.

7. Shitja e teksteve shkollore bëhet përkundërt faturave. Për kategoritë e nxënësve, që përfitojnë sipas pikës 6 të këtij vendimi, pagesa bëhet nëpërmjet llogarive buxhetore të DARZA-ve ose të vetë shkollës, kur ka llogari të tillë, me fondet e miratuara si “Transfertë tek individët” në buxhetin e Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës.

8. Procedurat e përdorimit dhe të shpërndarjes së fondeve buxhetore, për blerjen e teksteve shkollore, si dhe mënyra e pagesës për kategorinë e nxënësve përfitues, përcaktohen me udhëzim të përbashkët të Ministrisë së Financave dhe të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës.

9. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

10. Vendimi nr.260, datë 18.4.2007 i Këshillit të Ministrave “Për botimin, shtypjen dhe shpërndarjen e teksteve shkollore të sistemit arsimor parauniversitar”, të ndryshuar, si dhe aktet e tjera nënligjore, që janë në kundërshtim me këtë vendim, shfuqizohen.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.108, datë 17.2.2010

**PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME
PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN, NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM TË
KOMUNËS KURJAN TË QARKUT TË FIERIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 2, 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike shtetërore, brenda juridiksionit territorial dhe administrativ të komunës Kurjan të qarkut të Fierit, që transferohen në pronësi ose në përdorim të kësaj komune, sipas lidhjes nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

Lista e inventarit me 31 (tridhjetë e një) fletë, që i bashkëlidhet këtij vendimi, përfundon me numrin rendor 125 (njëqind e njëzet e pesë).

2. Ngarkohen Ministri i Brendshëm, kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe komuna Kurjan për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Komuna Kurjan

Lidhja nr.1

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
1	Prona që përdoren për realizimin e programeve administrative.	Në pronësi
2-10	Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore.	Në pronësi
11-15	Prona që përdoren për realizimin e veprimtarive social-kulturore e sportive.	Në pronësi
17-20	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në shëndetin publik.	Në pronësi
21-26	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në fushën e mbrojtjes civile.	Në pronësi
60-65	Varrezat publike	Në pronësi
66-72	Infrastrukturë (rrugë vendore)	Në pronësi
91, 96,111	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka joproductive dhe kanale të treta).	Në pronësi
112-115	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e ujësjellës-kanalizimeve.	Në pronësi

VENDIM
Nr.109, datë 17.2.2010

**PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME
PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM TË
KOMUNËS NIKËL TË QARKUT TË DURRËSIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, brenda juridiksionit territorial dhe administrativ të komunës Nikël të qarkut të Durrësit, që transferohen në pronësi ose në përdorim të kësaj komune, sipas lidhjes nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

Lista e inventarit me 101 (njëqind e një) fletë, që i bashkëlidhet këtij vendimi, përfundon me numrin rendor 541 (pesëqind e dyzet e një).

2. Ngarkohen Ministri i Brendshëm, kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe komuna Nikël për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Komuna Nikël

Lidhja nr.1

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
72-80	Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore.	Në pronësi
68-71	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në shëndetin publik.	Në pronësi
58	Prona që përdoren për realizimin e veprimtarive social-kulturore e sportive.	Në pronësi
59-67	Varrezat publike	Në pronësi
21-57	Infrastrukturë, troje të lira dhe hapësira të pazëna ndërmjet ndërtesave ose objekteve të çdo lloji.	Në pronësi
229-460, 465-519	Infrastrukturë (rrugë vendore, lulishte dhe sheshe publike)	Në pronësi
1-8, 10	Prona që përdoren në fushën e zhvillimit ekonomik.	Në pronësi
186-204,539,540	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka produktive).	Në përdorim
209 (vetëm kanalet e treta),214,220,224,228	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (kanale të treta dhe toka joproduktive).	Në pronësi

VENDIM
Nr.111, datë 17.2.2010

PËR MIRATIMIN E LISTËS PARAPRAKE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM TË KOMUNËS RRAJCË TË QARKUT TË ELBASANIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 2, 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të komunës Rrajcë të qarkut të Elbasanit, sipas lidhjes nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Lista paraprake, sipas kërkesave të këshillit të kësaj komune, është pjesë e listës së inventarit të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që janë brenda juridiksionit territorial dhe administrativ të komunës Rrajcë të qarkut të Elbasanit, miratuar me vendimin nr.924, datë 2.7.2008 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në komunën Rrajcë të qarkut të Elbasanit ”.

2. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe komuna Rrajcë për zbatimin e këtij vendimi. Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Komuna Rrajcë

Lidhja nr.1

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
3-9	Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore.	Në pronësi
10-13	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në shëndetin publik.	Në pronësi
15-69	Troje të lira dhe hapësira publike të pazëna ndërmjet ndërtesave ose objekteve të çdo lloji.	Në përdorim
70-82	Varreza publike	Në pronësi
596,597,600,601,604,606,607,608,609,611,612	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka produktive).	Në përdorim
599,603,605,623,624,628,641,644,648,651	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (kanale të treta dhe toka joproduktive).	Në pronësi
657,659,661,663-830	Infrastrukturë (sheshe, rrugë vendore, lulishte dhe shërbime publike).	Në pronësi
837-839	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e ujësjellës-kanalizimeve.	Në pronësi

VENDIM
Nr.112, datë 17.2.2010

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.112, DATË 21.2.2007 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR KRIJIMIN E FONDIT SHQIPTAR TË KONKURRUESHMËRISË”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 6, shkronjat “ç”, “d” dhe “ë” e, 7, shkronja “a”, të ligjit nr.8957, datë 17.10.2002 “Për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme”, të ndryshuar, të nenit 42 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, si dhe të nenit 10 të ligjit nr.10190, datë 26.11.2009 “Për buxhetin e vitit 2010”, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr.112, datë 21.2.2007 të Këshillit të Ministrave, të bëhen këto ndryshime:

1. Pika 1 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“1. Krijimin e Fondit Shqiptar të Konkurrueshmërisë, për vitin 2010, me vlerë prej 28 000 000 (njëzet e tetë milionë) lekësh.”.

2. Pika 5 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“5. Fondi Shqiptar i Konkurrueshmërisë të zbatohet për një periudhë 3-vjeçare, gjatë viteve 2010, 2011 dhe 2012.”.

3. Pika 8 shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.113, datë 24.2.2010

PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES, NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS FEDERALE TË
GJERMANISË, PËR BASHKËPUNIMIN FINANCIAR PËR KALIMIN E FONDIT NGA
“PROJEKTI KRUJA II” NË PROJEKTIN “PROGRAMI PËR MBROJTJEN E MJEDISIT TË
LIQENIT TË OHRIT- SHKARKIMI I UJËRAVE TË ZEZA NË POGRADec II”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe neneve 17 e 23 të ligjit nr.8371, datë 9.7.1998 “Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare”, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe Ministër i Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë, për bashkëpunimin financiar për kalimin e fondit nga “Projekti Kruja II” në projektin “Programi për mbrojtjen e mjedisit të liqenit të Ohrit-Shkarkimi i ujërave të zeza në Pogradec II”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

MARRËVESHJE

NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS FEDERALE TË GJERMANISË PËR BASHKËPUNIMIN FINANCIAR (FURNIZIMI ME UJË DHE SHKARKIMI I UJËRAVË TË ZEZA NË KRUIË II-VITET E PREMTIMIT 2001 DHE 2008)

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë,

në frymën e marrëdhënieve miqësore ekzistuese ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës Federale të Gjermanisë;

duke u nisur nga dëshira për t'i forcuar dhe thelluar këto marrëdhënie miqësore nëpërmjet bashkëpunimit financiar si partnerë;

të ndërgjegjshëm se ruajtja e këtyre marrëdhënieve përbën bazën e kësaj Marrëveshjeje;

me qëllim për të kontribuar në zhvillimin social dhe ekonomik në Republikën e Shqipërisë;

duke iu referuar protokolleve të bisedimeve ndërqeveritare të datës 5 dhjetor 2001 dhe të datës 7 tetor 2008 dhe notës verbale nr.09/09 të ambasadës së Republikës Federale të Gjermanisë të datës 16 janar 2009, si dhe marrëveshjes së datës 22 shtator 2003 ndërmjet Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë për bashkëpunimin financiar (Furnizimi me ujë dhe shkarkimi i ujërave të zeza në Krujë II-viti 2001),

u morën vesh si vijon:

Neni 1

1. Shumat e financimit, të parashikuara në marrëveshjen e datës 22 shtator 2003 ndërmjet Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë dhe Qeverisë së Republikës së Shqipërisë për bashkëpunimin financiar (Furnizimi me ujë dhe shkarkimi i ujërave të zeza në Krujë II-viti 2001) për projektin "Furnizimi me ujë dhe shkarkimi i ujërave të zeza në Krujë II", do të përdoren me një shumë prej 800 000 eurosh (tetëqind mijë eurosh) për projektin "Programi i mbrojtjes së mjedisit të liqenit të Ohrit-shkarkimi i ujërave të zeza në Pogradec II", kur nga shqyrtimi përkatës u konstatua se projekti në fjalë vlen për t'u mbështetur.

2. Përveç kësaj, janë të vlefshme dispozitat e marrëveshjes së datës 22 shtator 2003 ndërmjet Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë dhe Republikës së Shqipërisë për bashkëpunimin financiar (Furnizimi me ujë dhe shkarkimi i ujërave të zeza në Krujë II-viti 2001).

Neni 2

Kjo Marrëveshje hyn në fuqi në ditën kur Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë i njofton Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë, se janë përmbushur kushtet brendashtetërore për hyrjen e saj në fuqi. Përcaktuese është dita e marrjes së njoftimit.

Bërë në Tiranë, më datë 28.12.2009, në dy kopje origjinale, secila në gjuhën shqipe dhe gjermane, duke pasur secili tekst fuqi të barabartë.

VENDIM
Nr.124, datë 17.2.2010

PËR HAPJEN E PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË
NË UNIVERSITETIN “ISMAIL QEMALI”, VLORË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 26 dhe 42 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Hapjen, në Universitetin “Ismail Qemali”, Vlorë, të programeve të studimit, të ciklit të parë, në Fakultetin e Shkencave Teknike, si më poshtë:

- a) “Biologji”, në përfundim të të cilit lëshohet “Diplomë e nivelit të parë”, DNP, në biologji.
- b) “Fizikë”, në përfundim të të cilit lëshohet “Diplomë e nivelit të parë”, DNP, në fizikë.
- c) “Kimi”, në përfundim të të cilit lëshohet “Diplomë e nivelit të parë”, DNP, në kimi.
- d) “Ekonomiks”, në përfundim të të cilit lëshohet “Diplomë e nivelit të parë”, DNP, në ekonomiks.
- e) “Financë”, në përfundim të të cilit lëshohet “Diplomë e nivelit të parë”, DNP, në financë.
- f) “Inxhinieri elektrike”, në përfundim të të cilit lëshohet “Diplomë e nivelit të parë”, DNP, në inxhinieri elektrike.

2. Këto programe studimi të ciklit të parë realizohen me 180 kredite dhe kohëzgjatja normale e tyre është tri vite akademike.

3. Programet e studimit “Biologji”, “Fizikë”, “Kimi”, “Ekonomiks”, “Financë” dhe “Inxhinieri elektrike” ta fillojnë veprimtarinë mësimore në vitin akademik 2010-2011.

4. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i miratuar për universitetin “Ismail Qemali”, Vlorë.

5. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe universiteti “Ismail Qemali”, Vlorë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.126, datë 17.2.2010

PËR PËRCAKTIMIN E STRUKTURËS SË KOMISIONIT TË SHQYRTIMIT TË APLIKIMIT,
TË KRITEREVE, TË DOKUMENTACIONIT E TË KUSHTEVE, QË DUHET TË PLOTËSOJË
APLIKANTI, PËR T’U PAJISUR ME LICENCË PËR KAZINO, SI DHE TË RASTEVE TË
REVOKIMIT APO TË PEZULLIMIT TË KËSAJ LICENCE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 33 të ligjit nr.10 033, datë 11.12.2008 “Për lojërat e fatit”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Çdo person juridik apo bashkim personash juridikë, vendas ose i huaj, i organizuar si shoqëri aksionare, që kërkon të pajiset me licencë për kazino, duhet të aplikojë pranë autoritetit të autorizuar dhe të plotësojë kushtet e përcaktuara në ligjin nr.10 033, datë 11.12.2008 “Për lojërat e fatit”, të ndryshuar (në vijim referuar si “ligji”), në këtë vendim dhe në aktet e tjera, të dala në zbatim të ligjit.

2. Ministria e Financave është autoriteti i autorizuar, në vijim “Autoriteti”, për pajisjen e subjekteve me licencë për kazino.

3. Fjalët dhe shprehjet e përdorura në këtë vendim do të kenë të njëjtin kuptim me atë të dhënë në ligj dhe aktet e tjera të dala në zbatim të tij, përveçse kur konteksti e kërkon apo kur, në përputhje me kontekstin e dhënë, në këto akte përcaktohet shprehimisht ndryshe. Plotësimi i kushteve dhe i kriterëve shtesë, të kërkuara për subjektet e huaja, bëhet sipas dokumentacionit të përcaktuar në legjislacionin e huaj përkatës.

4. Në këtë vendim, si referencë do të konsiderohet çdo ndryshim ose rimiratim/zëvendësim i aktit, si dhe çdo rregull ose rregullore, nxjerrë në zbatim të atij akti, dhe referencë në një ligj do të konsiderohet referenca në një ligj të tillë, siç mund të jetë ndryshuar ose rimiruar/zëvendësuar, dhe fjala “ndryshuar” përfshin konceptin “shtuar dhe/ose abroguar”.

5. Aplikimi përbëhet nga tërësia e dokumenteve të përcaktuara në këtë vendim, ku përfshihen dhe dokumentet që i kërkojnë aplikuesit nga Komisioni i Shqyrtimit të Aplikimit (në vijim “Komisioni”), si kusht për shqyrtimin dhe marrjen e një vendimi për licencim, në formën dhe sipas kushteve të përcaktuara në këtë vendim.

6. Aplikuesi mund të paraqitet në formën e një bashkimi shoqërisht, në vijim “Bashkimi”, i përbërë nga disa persona të tjerë juridikë, vendas ose të huaj. Bashkimi duhet të caktojë dhe të autorizojë njërin nga anëtarët e tij, si kryesues, për t'i përfaqësuar dhe për të marrë përsipër, në mënyrë të parevokueshme, detyrime në emër të të gjithë anëtarëve të bashkimit për të gjitha çështjet, në lidhje me procesin e shqyrtimit të aplikimit, përfshi dhe licencimin dhe dorëzimin e aplikimit në formën e kërkuar. Anëtari kryesues merr përsipër që bashkimi i përkohshëm të mos ndryshojë përbërjen e tij, pa miratimin paraprak, me shkrim, të autoritetit.

7. Në rast bashkimi, asnjë anëtar i tij nuk mund të marrë pjesë, drejtpërdrejt ose tërthorazi në një bashkim tjetër që aplikon për të njëjtën veprimtari.

8. Aplikuesi do të përballojë të gjitha kostot për përgatitjen dhe dorëzimin e aplikimit, përfshirë, ndër të tjera, të gjitha kostot dhe shpenzimet për përgatitjen e përgjigjeve të pyetjeve apo të kërkesave për sqarime a takime të autoritetit.

9. Aplikimi, ku përfshihet dhe e gjithë korrespondenca, dhe dokumentet për këtë aplikim duhet të jenë në gjuhën shqipe dhe/ose angleze, përveç materialeve të botuara (p.sh.broshurat) të paraqitura nga aplikuesi, të cilat mund të jenë edhe në gjuhë të tjera, por të shoqëruara me përkthim, të vërtetuar në gjuhën shqipe ose angleze.

II. KUSHTET, KRITERET DHE DOKUMENTACIONI PËR PAJISJEN ME LICENCË PËR KAZINO

10. Aplikuesi ose, nëse është bashkim, të paktën anëtari kryesues, duhet të ketë përvojë në fushën e lojërave të fatit, të paktën në 3 vitet e fundit të veprimtarisë së tij, për të cilën paraqet një listë të veprimtarive, ku ai zhvillon lojëra fati, së bashku me autorizimet, miratimet apo lejet, në bazë të të cilave i ushtron këto veprimtari. Para dorëzimit të aplikimit, bashkimi i përkohshëm duhet të vërtetohet me një marrëveshje të nënshkruar nga të gjithë anëtarët dhe të noterizuar, ku të përcaktohet dhe anëtari kryesues.

11. Aplikuesi ose, nëse aplikuesi është bashkim, të gjithë anëtarët e bashkimit duhet të vërtetojnë origjinën e kapitaleve të tyre, duke paraqitur “Certifikatën e besueshmërisë”, dhënë nga organet shtetërore përgjegjëse, që merren me parandalimin e pastrimit të parave të vendeve të tyre, sipas së cilës aplikuesi dhe/ose anëtarët e bashkimit nuk janë dhe nuk kanë qenë në hetim dhe ose të dyshuar për pastrimin e parave.

12. Aplikuesi ose, nëse aplikuesi është bashkim, të paktën anëtari kryesues, duhet të provojë se ka pasur qarkullim vjetor minimalisht sa 5-fishin e tarifës së licencës për kazino, për secilin prej 3 (tri) viteve të plota financiare, të fundit, duke paraqitur pasqyrat financiare të audituara, të certifikuara nga ekspertë kontabël, për të tri vitet e plota financiare të fundit, përfshirë edhe bilancet e konsoliduara, pasqyrat e të ardhurave, pasqyrat e qarkullimit të parasë dhe shënimet shoqëruese.

13. Aplikuesi duhet të paraqesë, së bashku me aplikimin e tij, në formën dhe përmbajtjen e përcaktuar nga autoriteti, një garanci të aplikimit, në masën 10% të tarifës, që duhet të paguajë për marrjen e licencës. Nëse aplikuesi paraqitet në formën e një bashkimi, garancia e aplikimit duhet të jetë në emër të të gjithë anëtarëve të bashkimit. Garancia e aplikimit sekuestrohet dhe kalon tërësisht në favor të autoritetit, nëse ky i fundit vëren se aplikuesi:

a) ka deklaruar të dhëna të rreme në aplikimin e tij;
b) nuk ka paguar tarifën e aplikimit brenda afatit të përcaktuar nga autoriteti, në përputhje me këtë vendim;

c) tërhiqet nga kërkesa për shqyrtimin e aplikimit të tij, pasi ky i fundit është paraqitur;

ç) nuk ngurtëson në afatin, shumën dhe formën e kërkuar fondin e ngurtësimit, sipas përcaktimeve të këtij vendimi dhe legjislacionit për lojërat e fatit.

14. Aplikuesi, ose nëse aplikuesi është bashkim, secili prej anëtarëve të bashkimit, duhet të paraqesin aktet e themelimit dhe statutet e tyre, së bashku me certifikatën nga organi që mban regjistrin tregtar në vend, ku të jenë evidentuar emrat e aksionarëve të tyre dhe përqindja që ata zotërojnë në kompani, emrat e aksionarëve, që zotërojnë të drejta të veçanta, emrat e anëtarëve të organeve drejtuese, si dhe të dhëna të tjera për organet drejtuese të tyre, në rast se kërkohet nga autoriteti.

15. Për aksionarët që zotërojnë paketën kryesore të aksioneve, duhet të paraqiten të dhëna personale sipas shtojcës nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij. Të dhënat duhet të paraqiten edhe nga të gjithë aksionarët pjesëmarrës në grupin influencues të aplikuesit, sipas dispozitave të legjislacionit tregtar.

Nëse aplikuesi zotërohet nga një shoqëri, të dhënat duhet të paraqiten dhe për shoqërinë që zotëron aksionet dhe aksionarët e kësaj të fundit, deri tek aksionari që zotëron kontrollin e shoqërisë/shoqërive, që kontrollojnë shoqëritë, që zotërojnë aksionet e aplikuesit.

16. Aplikuesi duhet të paraqesë pasqyra financiare të audituara, të certifikuara nga ekspert(ë) kontabël, për tri (3) vitet e plota financiare të fundit, aty ku është e mundur, përfshirë bilancet e konsoliduara, pasqyrat e të ardhurave, pasqyrat e qarkullimit të parasë dhe shënimet shoqëruese për aksionarët e tij ose nëse aplikuesi është një bashkim shoqërisë, për të gjithë aksionarët e anëtarëve të tij.

17. Aplikuesi duhet të paraqesë një vetëdeklarim nga aksionarët e tij dhe anëtarët e organeve drejtuese, që vërteton se nuk është në ndjekje penale, si dhe:

a) Një dokument që vërteton se aplikanti nuk është në proces falimentimi, lëshuar nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit;

b) Një dokument që vërteton se (subjekti juaj) i ka plotësuar detyrimet fiskale, lëshuar nga administrata tatimore;

c) Një dokument që vërteton se (subjekti juaj) i ka paguar të gjitha detyrimet e sigurimeve shoqërore, lëshuar nga administrata tatimore.

Aplikuesi ose, nëse aplikuesi është bashkim, të paktën anëtari kryesues, për të plotësuar kriterin e përcaktuar në pikën 10 të këtij vendimi, ka të drejtë të paraqesë një evidencë për veprimtarinë e ndërmarra nga “Shoqëria mëmë” (siç përcaktohet më poshtë).

17.1 Aplikuesi duhet të paraqesë dokumente për kapacitetet organizative dhe administrative, sipas dokumentacionit të mëposhtëm:

a) Dëshmi për fuqinë mesatare punëtore dhe për numrin e stafit drejtues deri në 3 (tri) vitet e fundit;

b) Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik, për të përmbushur kontratën.

18. Aplikuesi ose, nëse aplikuesi është bashkim, të paktën anëtari kryesues, për të plotësuar kriterin e përcaktuar në pikën 12 të këtij vendimi, ka të drejtë të paraqesë një evidencë pasqyrash financiare të “Shoqërisë mëmë”.

19. “Shoqëri mëmë”, për efekt të zbatimit të këtij vendimi dhe në përputhje me legjislacionin që rregullon shoqëritë tregtare, konsiderohet çdo subjekt që kontrollon aplikuesin ose anëtarin kryesues të bashkimit të shoqërive. Përkufizimi “kontroll” nënkupton pasjen e shumicës së votave dhe të shumicës së përfaqësimit në asamblenë e përgjithshme (ose në organe të tjera të ngjashme).

20. Në rast se aplikuesi paraqet përvojat e operimit në fushën e lojërave të fatit dhe ato financiare të “Shoqërisë mëmë”, atëherë kjo e fundit do të jetë përgjegjëse solidare me aplikuesin për përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga licencimi. Garancia, në këtë rast, jepet nga organet drejtuese të “Shoqërisë mëmë” që kanë të drejtë të angazhojnë këtë të fundit në të tilla marrëdhënie. Forma dhe përmbajtja e kësaj garancie duhet të jenë të kënaqshme për autoritetin.

III. PROCEDURAT PËR MARRJEN E LICENCËS PËR KAZINO

21. Komisioni refuzon një aplikim, nëse vërtetohet se aplikuesi apo aksionarët e tij janë apo kontrollohen nga shoqëri të regjistruara si “(off shore)”.

22. Aplikuesi, që kërkon sqarime për kriteret kualifikuese ose për ndonjë kërkesë tjetër të përcaktuar, mund ta njoftojë me shkrim autoritetin.

23. Çdo aplikues duhet të përgatisë dhe të dorëzojë kopjen origjinale të aplikimit dhe 1 (një) kopje tjetër, mbi të cilat të vëre qartë shënimin përkatës “Origjinal” dhe “Kopje”. Në rast mospërputhjeje ndërmjet kopjes dhe origjinalit, do të merret për bazë origjinali.

24. Origjinali dhe të gjitha kopjet e aplikimit duhet të jenë të shtypura ose të shkruara me bojë që nuk fshihet. Personi ose personat me të drejtë nënshkrimi duhet ta nënshkruajnë aplikimin, duke nënshkruar origjinalin e aplikimit dhe duke shënuar inicialet në secilën faqe të origjinalit të aplikimit, me përjashtim të materialeve të botuara.

25. Aplikimi nuk duhet të ketë ndryshime, fshirje apo shtesa, me përjashtim të rastit kur korrigjimet nënshkruhen nga personi apo personat me të drejtë nënshkrimi të aplikimit.

26. Aplikuesi mbyll kopjen origjinale të aplikimit dhe çdo kopje tjetër në zarfe të veçanta, të nënshkruara “Aplikimi-origjinal” dhe “Aplikimi-kopje”. Zarfet vulozen dhe futen në një zarf tjetër më të madh, i cili gjithashtu vulozet. Zarfet e brendshme dhe të jashtme i drejtohen titullarit të autoritetit, në adresën “Ministria e Financave, bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, nr.4, Tiranë, Albania dhe mbi to shkruhet “Aplikim për licencë për kazino”.

27. Në secilin nga zarfet e brendshme duhet të jenë shënuar qartë emri dhe adresa e saktë e aplikuesit (në rastin e bashkimit, emri dhe adresa e anëtarit kryesues).

28. Komisioni kontrollon aplikimin brenda 20 ditëve nga data e protokollimit të tij, për të vendosur nëse dokumentet janë të plota, të nënshkruara siç duhet dhe nëse plotësojnë kërkesat në përgjithësi.

29. Në rast se dokumentet nuk janë të plota dhe në formën e kërkuar, komisioni i lë një afat deri në 30 ditë aplikuesit, për të plotësuar aplikimin. Dështimi i aplikuesit për të kthyer përgjigje apo për të plotësuar dokumentacionin sipas kërkesës së komisionit, i jep këtij të fundit të drejtën për të refuzuar aplikimin.

30. Komisioni, brenda 60 ditëve nga data e pranimit të shqyrtimit të aplikimit, duhet të marrë një vendim për pranimin apo refuzimin e aplikimit.

31. Nëse dokumentet e kërkuara janë të plota dhe në formën e parashikuar nga ky vendim, komisioni vendos pranimin e aplikimit dhe më pas fillon shqyrtimin e tij.

32. Nëse komisioni, në përputhje me nenin 34/4/d të ligjit nr.10 033, datë 11.12.2008 “Për lojërat e fatit”, të ndryshuar, e gjykon të nevojshme që aplikuesi duhet të paraqesë dokumente apo informacione shtesë, i kërkon atij dorëzimin e tyre, duke i përcaktuar një afat të arsyeshëm për plotësimin e informacionit apo të dokumentacionit. Në këtë rast, afati i parashikuar në pikën 25 të këtij vendimi, pezullohet deri në përmbushjen e kërkesave, sipas afatit të lënë nga komisioni.

33. Aplikuesit i lind e drejta për ankim për vendimin e komisionit vetëm për afatin për plotësimin e informacionit apo të dokumentacionit, sipas pikës 27 të këtij vendimi, te titullari i autoritetit, i cili merr vendim brenda 5 ditëve nga marrja e ankimit. Ankimi i aplikuesit nuk pezullon afatin që komisioni i ka lënë në dispozicion aplikuesit.

34. Dështimi i aplikuesit për të kthyer përgjigje apo për të plotësuar dokumentacionin sipas kërkesës së komisionit, i jep të drejtë komisionit për ta refuzuar aplikimin.

35. Çdo aplikim, që nuk i përmbush kërkesat e parashtruara, refuzohet nga komisioni duke humbur edhe të drejtën për t’u marrë në konsideratë për shqyrtim në një kohë tjetër.

36. Autoriteti ka të drejtë të verifikojë çdo informacion dhe dokument të dhënë nga aplikuesi edhe kur aplikuesi është bashkim, për të gjithë anëtarët e bashkimit. Për këtë aplikuesi përfshin në aplikimin e tij, sipas formatit të kërkuar nga autoriteti, një autorizim, që autorizon autoritetin për të bërë, pa asnjë kufizim, verifikimin e dokumentacionit dhe/ose të informacionit të dhënë në aplikim. Dështimi i aplikuesit për të dhënë një autorizim të tillë sjell refuzimin e aplikimit.

37. Në rast se autoriteti kërkon verifikimin e një informacioni apo të dokumentacionit pranë organeve, që e kanë lëshuar apo tek organet kompetente shtetërore shqiptare apo të huaja, atëherë afati i shqyrtimit të aplikimit pezullohet për kohën që këtyre organeve u duhet për të kthyer përgjigje.

38. Pas shqyrtimit paraprak, komisioni vlerëson imtësisht aplikimin e pranuar, për të përcaktuar nëse përmbush kriteret e kualifikimit, duke pasur parasysh rregullin e mëposhtëm:

a) Kriteret e kualifikimit të përcaktuara në pikat 10 deri 17 të këtij vendimi, bazohen në metodën: “kalon”/“nuk kalon” për secilin kriter.

b) Aplikimi që është pranuar nga komisioni, nisur nga përputhja me kërkesat dhe kriteret e kualifikimit, të përcaktuara nga pikat 10 deri 22 të këtij vendimi, quhet "Aplikim i pranuar".

c) Aplikimi, cilësuar nga komisioni si i papërputhshëm me kërkesat dhe kriteret e kualifikimit, të përcaktuara nga pikat 10 deri në 22 të këtij vendimi, quhet "aplikim i refuzuar".

39. Aplikuesi, aplikimi i të cilit është vlerësuar nga komisioni si "Aplikim i refuzuar", njoftohet nga komisioni brenda 5 ditëve nga data e marrjes së vendimit për refuzim, duke i njoftuar dhe shkaqet e këtij refuzimi.

40. Aplikuesi ka të drejtë ta ankimojë vendimin e komisionit për refuzimin e aplikimit të titullari i autoritetit, brenda 30 ditëve nga data e marrjes njoftim apo nga data kur ai duhet të kishte marrë njoftim. Titullari i autoritetit, brenda 30 ditëve nga data e marrjes së ankimit, njofton aplikuesin për vendimin e marrë për ankimin e tij, duke argumentuar pranimin apo refuzimin e këtij ankimi.

41. Aplikuesi, aplikimi i të cilit është cilësuar nga komisioni si "aplikim i pranuar", njoftohet nga kryetari i komisionit:

a) për të paguar tarifën e licencës, brenda 30 ditëve nga data e marrjes së njoftimit, duke i përcaktuar shumën përkatëse dhe numrin e llogarisë a bankën, ku duhet bërë pagesa;

b) për të dorëzuar fondin e garancisë së fituesit, brenda 30 ditëve nga data e marrjes së njoftimit, në formën e një garancie bankare në favor të Ministrisë së Financave, të lëshuar nga një bankë me seli në territorin e Republikës së Shqipërisë, duke i treguar dhe formën dhe përmbajtjen e kësaj garancie;

c) për të dorëzuar dokumentacionin, që vërteton krijimin e shoqërisë, që do të marrë licencën, sipas parashikimeve të pikës 5 të nenit 36 të ligjit nr.10 033, datë 11.12.2008 "Për lojërat e fatit", të ndryshuar, nëse aplikuesi është person juridik i huaj dhe/ose bashkim. Në këtë rast ai duhet të plotësojë edhe kushtet e përcaktuara në shkronjat "a" e "b" të kësaj pike.

Nëse aplikuesi është bashkim, ai nuk duhet të ndryshojë strukturën e bashkimit, pa miratimin paraprak, me shkrim, të autoritetit.

42. Nëse aplikuesi është person juridik i huaj dhe/ose bashkim dhe në përputhje me shkronjën "c" të pikës 41 të këtij vendimi, do të krijojë një person juridik për efekt të licencimit, atëherë pronësia e aksioneve të personit juridik të krijuar sipas shkronjës së sipërpërmendur dhe çdo ndryshim në pronësinë e aplikuesit dhe ose të aksionarëve të tij, që do të sillte në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe/ose të tërthortë një ndryshim në kontrollin e të licencuarit në krahasim me çastin kur aplikimi është paraqitur, duhet të bëhet me pëlqimin paraprak të Ministrisë së Financave.

Çdo shkelje e këtij rregulli, i cili është i aplikueshëm si për personat juridikë, të krijuar për efekt të shkronjës "c" të pikës 41 të këtij vendimi, si dhe për çdo aplikues tjetër, që është licencuar sipas këtij vendimi, përbën kusht për revokimin e licencës nga autoriteti.

43. Autoriteti, brenda 5 ditëve nga çasti kur banka ka konfirmuar pagesën në llogarinë e autoritetit dhe kur aplikuesi ka plotësuar kushtet e tjera të përcaktuara në këtë vendim, i jep aplikuesit licencën për kazino, ku përcaktohen dhe kushtet për ushtrimin e kësaj veprimtarie.

44. Licenca jepet për një afat 10-vjeçar dhe është e vlefshme nga çasti i lëshimit të saj.

45. I licencuari ka të drejtë ta fillojë veprimtarinë për kazino nga çasti i marrjes së licencës dhe pas plotësimit të kushteve të përcaktuara në nenin 38 të ligjit, të këtij vendimi dhe të legjislacionit në fuqi për lojërat e fatit, në përgjithësi, në lidhje me kazinotë.

46. Komisioni i shqyrtimit të aplikimit ngrihet me urdhër të titullarit të autoritetit, kryesohet nga zëvendësministri i Financave dhe ka në përbërje këta anëtarë:

a) Një përfaqësues nga Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës;

b) Një përfaqësues nga Ministria e Brendshme;

c) Një përfaqësues nga Njësia e Mbikëqyrjes së Lojërave të Fatit;

ç) Një përfaqësues nga Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave.

47. Komisioni cakton sekretarin e komisionit, i cili merr pjesë, pa të drejtë vote, në mbledhjet e komisionit dhe është përgjegjës për protokollimin e mbledhjeve, të vendimeve dhe, në përgjithësi, të korrespondencës me aplikuesit.

48. Vendimet e komisionit janë të vlefshme kur në mbledhje marrin pjesë të gjithë anëtarët e tij dhe për një vendim të caktuar kanë votuar pro të paktën 3 (tre) anëtarë.

49. Votimi është i hapur dhe nuk lejohet abstenimi. Anëtarët, që votojnë kundër, duhet ta argumentojnë votën e tyre.

50. Përveç sa parashikohet shprehimisht nga ligji nr.10 033, datë 11.12.2008 “Për lojërat e fatit”, të ndryshuar, titullari i autoritetit revokon licencën e dhënë kur vërtetohet se aplikuesi ka paraqitur në aplikimin e tij një informacion të pasaktë dhe/ose të rremë apo kur në ndonjë çast gjatë ushtrimit të veprimtarisë nuk është në përputhje me kushtet, ku përfshihen edhe ndalimet dhe/ose kufizimet, që ka plotësuar si kusht për marrjen e licencës. Në rast se aplikuesi është bashkim i shoqërive, përputhja me kushtet e licencimit sipas këtij paragrafi shtrihet dhe mbi të gjithë anëtarët e bashkimit.

51. Titullari i autoritetit pezullon licencën, përveç rasteve të parashikuara në Kodin e Procedurës Administrative, edhe në rastet e mëposhtme, kur i licencuari:

- a) nuk ka përmbushur ndonjë nga kushtet e përcaktuara nga legjislacioni për lojërat e fatit;
- b) nuk kryen ndryshimet në rregulloren e lojërave dhe të kazinosë, të kërkuara nga autoriteti;
- c) nuk ka shlyer detyrimet fiskale brenda afateve të përcaktuara nga legjislacioni në fuqi.

52. Titullari i autoritetit, në urdhrin për pezullim, përcakton edhe afatin e pezullimit, i cili nuk mund të zgjasë më shumë se 3 muaj nga çasti kur i licencuari ka plotësuar mospërmbushjen.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

SHTOJCA 1

VETËDEKLARIM PËR PLOTËSIMIN E KRITEREVE PËR APLIKIM PËR LICENCË PËR KAZINO

[Datë]

Për: [Ministrinë e Financave/adresa]

[Emri i aplikuesit/anëtari kryesues i bashkimit të përkohshëm] deklaroj dhe garantoj me përgjegjësi të plotë se në datën e këtij vetëdeklarimi:

Z.[Emri i aksionarit për të cilin kërkohet informacion/anëtari kryesues i bashkimit], i datëlindjes..., mbajtës i pasaportës/ID nr., lëshuar nga..., lindur në... banues në..., me adresë:..., nr.tel.:

- a) nuk u është nënshtruar procedurave të falimentimit ose likuidimit;
- b) nuk është dënuar ose akuzuar për mashtrim, korrupsion, pastrim parash apo pjesëmarrje në vepra penale; dhe
- c) nuk ka dijeni për konflikt interesi ekzistues ose për ndonjë konflikt interesi të mundshëm që vjen si rezultat i kontratave ose marrëdhënieve të mëparshme apo atyre ekzistuese, ose çështje që mund të ndikojnë konkretisht në përmbushjen e detyrimeve të tyre sipas kontratës së koncensionit.

I juaji sinqerisht,
Nënshkrimi i personit të autorizuar
Emri dhe pozicioni i nënshkruesit
Emri i aplikuesit/kryesuesit të bashkimit
Adresa

VENDIM
Nr.131, datë 24.2.2010

**PËR KALIMIN NË PRONËSI, PA SHPËRBLIM, TË NJË PRONE, MISIONIT TË BAMIRËSISË
“MOTRAT E NËNË TEREZËS”**


Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 4 të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Shtetit për Reformat dhe Marrëdhëniet me Kuvendin, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin në pronësi, pa shpërblim, misionit të bamirësisë “Motrat e Nënë Terezës”, të pronës, truall, me sipërfaqe 2 000 (dy mijë) m², të ndodhur në rrugën “Irfan Tomini”, Tiranë, sipas planvendosjes, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Kalimi i pronësisë të bëhet për misionin e bamirësisë “Motrat e Nënë Terezës”, sipas dispozitave të Kodit Civil.
3. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Emri: <u>5. AGA</u>	ZONA KADASTRALE <u>8250</u>
Licensa Nr.T _____ Dt. / /	NR. PASURISE <u>1124</u> VOL. <u>16 FO 59</u>
Data e pergatitjes <u>11.02.2010</u>	INDEKSI I HARTES <u>72-2-8</u>
<u>PASURIA</u>	SHKALLA <u>1:500</u>
NR. <u>1124</u> ME SYZ <u>3895.0 M²</u>	ADRESA E PASURISE: Rrethi _____
<u>NANDET</u>	Q/P <u>FIRANE</u> R/V <u>I. TOMINI</u>
NR. <u>1143</u> ME SYZ <u>2635.0 M²</u>	P/G _____ Sh _____ K _____ Ap _____
Vula / Firma _____	PRONARI/ET <u>JULLEN TABAKU</u>
<u>1144</u> ME SYZ <u>1200 M² (SHTET)</u>	



VENDIM
Nr.133, datë 24.2.2010

PËR KRIJIMIN E TASK-FORCËS PËR KËRKIMIN, GJETJEN DHE IDENTIFIKIMIN E PERSONAVE TË EKZEKUTUAR GJATË VITEVE TË REGJIMIT KOMUNIST

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, me propozimin e Ministrit të Brendshëm dhe Ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Krijimin e Task-Forcës për kërkimin, gjetjen dhe identifikimin e personave të ekzekutuar gjatë viteve të regjimit komunist, e cila të kryesohet nga zëvendësministri i Brendshëm dhe të ketë në përbërje këta anëtarë:

- a) Drejtorin e Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave;
- b) Drejtorin e Arkivit të Shërbimit Informativ Shtetëror;
- c) Drejtorin e Arkivit të Ministrisë së Brendshme;
- ç) Drejtorin e Arkivit Qendror në Ministrinë e Mbrojtjes;
- d) Zëvendësdrejtorin e Përgjithshëm të Policisë së Shtetit;
- dh) Nëndrejtorin e Përgjithshëm të Burgjeve;
- e) Nëndrejtorin e Institutit të Mjekësisë Ligjore;
- ë) Kryetarin e Institutit të Përndjekurive Politikë.

2. Në mbledhjet e Task-Forcës ftohen të marrin pjesë përfaqësues të sistemit të drejtësisë dhe të institucioneve të tjera të interesuara, kur çmohet se pjesëmarrja e tyre do të jetë e vlefshme për përmbushjen e misionit të saj.

3. Task-Forca ndihmohet nga sekretariati teknik, i cili ka në përbërje:

- a) Një përfaqësues nga Drejtoria e Përgjithshme e Kodifikimit në Ministrinë e Drejtësisë;
- b) Një përfaqësues nga Drejtoria Juridike në Ministrinë e Brendshme;
- c) Një përfaqësues nga Policia e Shtetit.

4. Task-Forca ka si qëllim kërkimin, gjetjen dhe identifikimin e personave të ekzekutuar gjatë viteve të regjimit komunist. Për realizimin e këtij qëllimi, ajo bashkërendon punën për:

- a) identifikimin e personave të ekzekutuar gjatë viteve të regjimit komunist, për të cilët nuk dihet vendi i varrimit;
- b) identifikimin dhe zbulimin e vendndodhjeve të varreve;
- c) gjetjen e eshtrave, verifikimin dhe identifikimin e tyre.

5. Task-Forca mblidhet me kërkesë të kryetarit të saj. Mbledhjet zhvillohen në mjediset e Ministrisë së Brendshme.

6. Kryetari i Task-Forcës raporton me shkrim, pas çdo mbledhjeje, pranë Kryeministrit, lidhur me ecurinë, problematikat e hasura, masat e ndërmarra dhe rezultatet konkrete të arritura. Kryetari i Task-Forcës, me kërkesë të Kryeministrit, raporton pranë Kryeministrit edhe për çështje të veçanta.

7. Anëtari i Task-Forcës kryen këto detyra:

- a) harton planet e masave, sipas fushës së veprimtarisë që mbulon;
- b) bashkërendon të gjitha veprimtaritë me institucionet e tjera;
- c) raporton periodikisht, pranë kryetarit të Task-Forcës, lidhur me ecurinë dhe rezultatet e arritura nga institucioni që përfaqëson.

8. Institucionet e përmendura në pikën 3, brenda 5 ditëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, dërgojnë pranë kryetarit të Task-Forcës emrat e përfaqësuesve të institucioneve të tyre.

9. Ngarkohen Ministria e Brendshme, Ministria e Drejtësisë, Policia e Shtetit dhe anëtarët e Task-Forcës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.135, datë 3.2.2010

PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE PËR NDARJEN E FONDIT PËR ZHVILLIMIN E RAJONEVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 15 të ligjit nr.10 190, datë 26.11.2009 “Për buxhetin e vitit 2010”, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Përcaktimin e kriterëve për ndarjen e Fondit për Zhvillimin e Rajoneve, si më poshtë vijon:
 - a) Përpërsitë e qeverisë për sektorë dhe zona të ndryshme;
 - b) Numri i popullsisë në secilin qark;
 - c) Niveli i varfërisë sipas qarqeve;
 - ç) Përfitimti i investimeve në 4 (katër) vitet e fundit.
2. Përqindja e kriterëve, në raport me totalin e investimeve, është:
 - a) Përpërsitë e qeverisë për sektorë dhe zona të ndryshme, 20%;
 - b) Numri i popullsisë në secilin qark, 25%;
 - c) Niveli i varfërisë sipas qarqeve, 35%;
 - ç) Përfitimti i investimeve në 4 (katër) vitet e fundit, sipas sektorëve përkatës, 20%.
3. Ministria e Financave, në bazë të kriterëve e të peshës së tyre specifike, për ndarjen e Fondit për Zhvillimin e Rajoneve, harton një formulë, të cilën, nëpërmjet një udhëzimi, ua dërgon për zbatim ministrive të linjës, që disponojnë fonde për zhvillimin rajonal.
4. Ministrinë e linjës, në mbështetje të këtyre kriterëve dhe të formulës për shpërndarjen e fondeve ndërmjet qarqeve, bëjnë llogaritjet përkatëse dhe për ndarjen e këtyre fondeve njoftojnë me shkrim Ministrinë e Financave dhe sekretariatit e përgjithshëm të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve.
5. Sekretariatet teknike të ministrive të linjës dhe të institucioneve të tjera i dërgojnë sekretariatit teknik, në Ministrinë e Financave, dhe sekretariatit të përgjithshëm të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve listën e projekteve të paraqitura nga njësitë e qeverisjes vendore, të shoqëruar me vlerësimet ekonomiko-teknike.
6. Ministrinë e linjës, për projektet e financuara me grantin konkurrues e të papërfunduara dhe për avancimin e punimeve ende të papaguara, përgatisin një listë, të cilën ia dërgojnë Ministrisë së Financave dhe sekretariatit të përgjithshëm të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve, të paktën dy javë pas mbledhjes së tij të parë.
7. Kriteret e vlerësimit të projekteve, që do të paraqiten për të përfutur nga Fondi për Zhvillimin e Rajoneve, ndërmjet njësite të qeverisjes vendore brenda qarkut, mbi të cilat do të mbështetet komiteti për marrjen e vendimeve janë si më poshtë vijon:
 - a) Shkalla e përputhshmërisë me përpërsitë/strategjitë vendore dhe/ose të zhvillimit të qarkut dhe në nivel kombëtar;
 - b) Shkalla e ndikimit në reduktimin e varfërisë dhe të rritjes së aksesit në shërbimet bazë;
 - c) Numri i përfituesve në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe të tërthortë nga projekti;
 - ç) Dhënia e përpërsisë, për rrugët dhe infrastrukturën vendore, projekteve ndërkomunale e projekteve të mëdha me ndikim në mbi dy njësi vendore;
 - d) Cilësia e projekteve teknike, të propozuara nga njësitë e qeverisjes vendore;
 - dh) Niveli i mbledhjes së taksave e të tarifave vendore;
 - e) Niveli i bashkëfinancimit nga njësitë e qeverisjes vendore apo fondet e donatorëve.
8. Sekretariatit teknik në Ministrinë e Financave përgatit materialin përmbledhës të listës së projektpropozimeve për çdo qark, të cilin ia dërgon sekretariatit të përgjithshëm të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve, të paktën, dy javë para mbledhjes së tij.
9. Ministria e Brendshme paraqet, pranë sekretariatit të përgjithshëm të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve, përpërsitë e zhvillimit, në nivel vendor, në përputhje me strategjitë e zhvillimit të qarqeve.
10. INSTAT-i siguron të gjitha të dhënat e nevojshme për sekretariatit e përgjithshëm të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve dhe institucionet e tjera qendrore, të cilat do të shërbejnë për të analizuar projektet e dërguara për financim.

11. Departamenti i Bashkëndimit të Strategjive dhe Koordinimit të Ndhmës së Huaj (DEBASKON), pranë Këshillit të Ministrave, kryen rolin e sekretariatit të përgjithshëm të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve. Sekretariati i përgjithshëm administron dhe përgatit materialet, që do të diskutohen nga Komiteti për Zhvillimin e Rajoneve, duke analizuar projektet e investimeve, në përputhje me përparësitë strategjike kombëtare e të programit politik të qeverisë, si dhe i sugjeron komitetit çështje për vendimmarrje.

12. Ngarkohet Ministri i Financave për nxjerrjen e një udhëzimi për procedurat, që duhet të ndiqen nga ministritë e linjës dhe institucionet e tjera.

13. Ngarkohen Ministri i Financave, Ministri i Brendshëm, Ministri i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Ministri i Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Ministri i Arsimit dhe Shkencës, Ministri i Shëndetësisë, Ministri i Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, Ministri i Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Ministri i Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, Fondi Shqiptar i Zhvillimit, INSTAT-i dhe Departamenti i Bashkëndimit të Strategjive dhe Koordinimit të Ndhmës së Huaj për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

UDHËZIM Nr.4, datë 17.2.2010

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR.1, DATË 13.6.2000 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR STRUKTURËN E RENDITJES SË PUNËVE NË SHËRBBIMIN CIVIL, METODOLOGJINË PËRKATËSE DHE PËRSHKRIMIN PËRGJITHËSUES TË ROLIT TË SEKRETARIT TË PËRGJITHSHËM NË KËTË SHËRBBIM”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 11 të ligjit nr.8549, datë 11.11.1999 “Statusi i nëpunësit civil”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në udhëzimin nr.1, datë 13.6.2000 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, të bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Në fund të titullit “Klasa I-nëpunës civilë të nivelit të lartë drejtues” të aneksit nr.2, të shtohet një paragraf, me këtë përmbajtje:

“Nëpunësit e emëruar në pozicionet, që u përkasin shkallëve 19, 21 e 22, duhet të kenë të paktën një “Diplomë të nivelit të dytë” (DND) ose “Diplomë të integruar të nivelit të dytë” (DIND), ose diploma të barasvlefshme me to, sipas legjislacionit të arsimit të lartë.”.

2. Në fund të titullit “Klasa II-nëpunës civilë të nivelit të mesëm drejtues” të aneksit nr.2, të shtohet një paragraf, me këtë përmbajtje:

“Nëpunësit e emëruar në pozicionet, që u përkasin shkallëve 16 e 18, duhet të kenë të paktën një “Diplomë të nivelit të dytë” (DND) ose “Diplomë të integruar të nivelit të dytë” (DIND), ose diploma të barasvlefshme me to, sipas legjislacionit të arsimit të lartë.”.

3. Në titullin “Klasa III-nëpunës civilë të nivelit të ulët drejtues” të aneksit nr.2, të bëhen ndryshimet dhe shtesat e mëposhtme:

a) Paragrafi i parë ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Në këtë klasë përfshihen shkallët: 12, 13 dhe 14”;

b) Në fund të titullit “Klasa III- nëpunës civilë të nivelit të ulët drejtues” të aneksit nr.2, shtohet një paragraf, me këtë përmbajtje:

“Nëpunësit e emëruar në pozicionet, që u përkasin shkallëve 13 e 14, duhet të kenë të paktën një “Diplomë të nivelit të dytë” (DND) ose “Diplomë të integruar të nivelit të dytë” (DIND), ose diploma të barasvlefshme me to, sipas legjislacionit të arsimit të lartë, ndërsa nëpunësit e emëruar në pozicionet, që

i përkasin shkallës 12, duhet të kenë të paktën një “Diplomë të nivelit të parë” (DNP) ose diploma të barasvlefshme me këtë diplomë, sipas legjislacionit të arsimit të lartë, së bashku me një diplomë “Master i nivelit të parë” (MNP).”.

c) Në fund të titullit “Klasa IV-nëpunës civilë të nivelit ekzistues” të aneksit nr.2, të shtohet një paragraf, me këtë përmbajtje:

“Nëpunësit e emëruar në pozicionet, që i përkasin shkallëve 8 e 10, duhet të kenë të paktën një “Diplomë të nivelit të parë” (DNP), ose diplomë të barasvlefshme me të, sipas legjislacionit të arsimit të lartë.”.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

UDHËZIM
Nr.8, datë 2.3.2010

PËR DISA SHTESA E NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR.26, DATË 16.4.2009 “PËR MBLEDHJEN E KONTRIBUTEVE TË DETYRUESHME TË SIGURIMEVE SHOQËRORE DHE SHËNDETËSORE”

Në mbështetje të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe në zbatim të ligjit nr.9136, datë 11.9.2003 “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të ligjit nr.9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” dhe të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.1114, datë 30.7.2008, të ndryshuar, me propozim të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, Ministri i Financave

UDHËZON:

Në udhëzimin nr.26, datë 16.4.2009 “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore” të bëhen këto shtesa e ndryshime:

1. Në paragrafin e fundit të kreut I, fjalia e parë dhe pikat nga “a” në “g” ndryshohen si vijon:

Për personat kryefamiljarë, që punësojnë persona si punëtorë shtëpie, në kuptimin e vendimit të Këshillit të Ministrave nr.1114, datë 30.7.2008, të zbatohen rregullat si vijon:

a) Kryefamiljari, i cili në këtë rast është përcaktuar në rolin e punëdhënësit, ka detyrimin për regjistrim në drejtorinë rajonale tatimore, e cila mbulon territorin ku kryefamiljari ka banimin e tij sipas përcaktimit në nenin 12 të Kodit Civil.

b) Kryefamiljari, që punëson persona si punëtorë shtëpie, në momentin e paraqitjes për regjistrim në organin tatimor, duhet të dorëzojë atje kërkesën me shkrim, si dhe kopje të marrëveshjes së punës së nënshkruar ndërmjet palëve, ku përveç të tjerave të jenë të shënuara, detyrimisht, numri i sigurimit shoqëror të personit të punësuar, koha e fillimit të punës, zgjatja e saj “me ose pa afat”, si dhe paga mujore bruto.

Drejtoria rajonale tatimore, me marrjen e kërkesës për regjistrim shoqëruar me dokumentet si më sipër, pasi bën verifikimet për rregullsinë e tyre, asiston kryefamiljarin për plotësimin e formularit të regjistrimit të tatimpaguesit, me të gjitha të dhënat e kërkuara, i cakton NIPT-in, të cilin ia dorëzon apo dërgon, zyrtarisht, kryefamiljarit përkatës brenda dy ditëve pune nga dita e plotësimit të formularit.

Për realizimin e regjistrimit të subjekteve “Kryefamiljar që punëson persona si punëtorë shtëpie”, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve krijon rubrikat përkatëse në formularin tip “Kërkesë për regjistrim”.

Për këtë kategori subjektsh drejtoria rajonale tatimore mban një regjistër të veçantë.

c) Kontributet e sigurimeve shoqërore për personat e punësuar si punëtorë shtëpie, deklarohen e paguhen nga kryefamiljari, që i punëson, në llogaritë bankare, të përcaktuara sipas procedurave, të vendosura për këtë qëllim. Deklarimi dhe pagesa e kontributeve bëhen çdo tre muaj, me të njëjtin dokumentacion dhe rregulla që zbatohen për personat e vetëpunësuar në biznesin e vogël.

Në formularin “Listëpagesa e sigurimeve shoqërore, shëndetësore dhe tatimit mbi të ardhurat nga punësimi” E-SIG 025/a.2, në rreshtat përkatës të çdo muaji të tremujorit, kryefamiljari shënon, emrin e mbiemrin e personave të punësuar si punëtorë shtëpie dhe numrin e sigurimit shoqëror. Shumën fikse të kontributit shoqëror e regjistron në kolonat “gjithsej” dhe “punëdhënësi”. Gjithashtu në listëpagesë shënohen dukshëm fjalët “punëtorë shtëpie”.

Shumat tremujore të listëpagesës regjistrohen në rubrikat respektive të dokumentit “Formular i deklarimit dhe pagesës së kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe sigurimeve shëndetësore” nr.E-SIG 011-012/a. Gjithashtu, në formular shënohen dukshëm fjalët “punëtor shtëpie”.

ç) Kryefamiljari, që punëson persona si punëtorë shtëpie, është i detyruar të deklarojë dhe paguajë kontributet për personat që punëson, pavarësisht se ata gjatë periudhës tatimore mund të jenë të punësuar edhe në punëdhënës të tjerë ose të vetëpunësuar, dhe gjithashtu të njëjtin veprim janë të detyruar të kryejnë edhe punëdhënësit e tjerë ose të vetëpunësuarit, në rastin e anasjellë.

d) Çregjistrimi nga organi tatimor i kryefamiljarit, që punëson persona si punëtorë shtëpie, do të bëhet duke paraqitur në drejtorinë rajonale tatimore vetëm një kërkesë me shkrim nga kryefamiljari, si dhe formularin e ndryshimeve në regjistrim të plotësuar nga ana e tij. Çregjistrimi nga organet tatimore i kryefamiljarit, që punëson persona si punëtorë shtëpie, miratohet zyrtarisht nga drejtori i drejtorisë rajonale tatimore brenda dy ditëve pune.

Përpara çregjistrimit nga organi tatimor kryefamiljari, që punëson persona si punëtorë shtëpie, duhet të ketë plotësuar të gjitha detyrimet ndaj administratës tatimore për dorëzimin e dokumentacionit dhe pagimin e detyrimeve.

dh) Në kuptimin e zbatimit të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.1114, datë 30.7.2008 dhe të këtij udhëzimi, për personat e punësuar si punëtorë shtëpie, njëlloj me kryefamiljarin, trajtohet edhe çdo shtetas shqiptar apo i huaj, madhor me zotësi për të vepruar.

e) Personat e punësuar si punëtorë shtëpie, sikurse dhe personat e vetëpunësuar në veprimtari tregtare apo shërbimi, ambulante, pajisen me librezën e kontributit, nga strukturat e sigurimeve shoqërore, të cilat janë të detyruara t’ia plotësojnë në vijimësi, në bazë të kontributeve të paguara, duke shënuar në librezë “Të siguruar vetëm për pension”.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I FINANCAVE
Ridvan Bode

VENDIM
Nr.32, datë 15.2.2010

PËR MIRATIMIN E UDHËZIMIT “PËR NDIHMËN SHTETËRORE PËR MBROJTJEN E MJEDISIT”

Në mbështetje të nenit 17 shkronja “d” të ligjit nr.9374, datë 21.4.2005 “Për ndihmën shtetërore”, të ndryshuar, Komisioni i Ndhmës Shtetërore

VENDOSI:

1. Miratimin e udhëzimit “Për ndihmën shtetërore për mbrojtjen e mjedisit”, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Dritan Prifti

UDHËZIM PËR NDIHMËN SHETËRORE PËR MBROJTJEN E MJEDISIT

1. HYRJE

Objekti i këtij udhëzimi është përcaktimi i kushteve dhe kriterëve, në përputhje me të cilat mund të lejohet ndihma shtetërore për mbrojtjen e mjedisit.

Objektivi kryesor i kontrollit të ndihmës shtetërore në fushën e mbrojtjes së mjedisit është të sigurojë që masat e ndihmës shtetërore të çojnë në një nivel më të lartë të mbrojtjes së mjedisit, krahasuar me atë që do të arrihej pa ndihmën, si dhe duke marrë parasysh parimin që ndotësi paguan (këtu e më poshtë: "PNP"), të sigurojnë që efektet pozitive të ndihmës të tejkalojnë efektet negative të saj, që kanë të bëjnë me shtrembërimet e konkurrencës.

Veprimtaritë ekonomike mund ta dëmtojnë jo pak mjedisin përmes ndotjes. Në disa raste, në mungesë të ndërhyrjes së shtetit, ndërmarrjet mund të shmangin përballimin e kostos së plotë të dëmit mjedisor që shkaktohet nga veprimtaria e tyre. Si rezultat, tregu nuk arrin të ndajë burimet në mënyrë të efektshme, meqenëse pasojat e jashtme (eksternalitetet negative) të prodhimit nuk merren parasysh dhe nuk përballohen nga vetë, prodhuesi, por përballohen nga shoqëria, si e tërë.

Edhe pse aktualisht ka kufizime në zbatimin e parimit që ndotësi paguan, dështimi rregullator nuk duhet të pengojë dhënësit e ndihmës që të imponojnë kërkesa për mbrojtjen e mjedisit, apo të reduktojnë eksternalitetet negative në masën më të madhe të mundshme.

Ky udhëzim ka të bëjë me masat e ndihmës shtetërore për mbrojtjen e mjedisit, në të gjithë sektorët duke përfshirë edhe sektorët e ndjeshëm. Ai zëbërthen, në mënyrë të hollësishme, kriteret e procedurat e përcaktuara në nenin 13/1 të ligjit nr.10 183, datë 29.10.2009 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.9374, datë 21.4.2005 "Për ndihmën shtetërore" (këtu e më poshtë "Ligji"), që duhet të zbatohen nga dhënësit e ndihmës gjatë hartimit dhe miratimit të planeve për ndihmë shtetërore për mbrojtjen e mjedisit.

Udhëzimi do të zbatohet për të gjitha masat që njoftohen në DNSH, por edhe për vlerësimin e të gjitha ndihmave të panjofuara, për të cilat do të zbatohen dispozitat e ndihmës së paligjshme.

1.1 Instrumenti më i përshtatshëm

Rregulloret dhe instrumentet bazë të tregut janë mjetet më të rëndësishme për arritjen e objektivave mjedisore. Instrumentet e buta, të tilla si vendosja e standardeve vullnetare të mjedisit, si dhe përhapja e teknologjive që përmbushin standardet mjedisore, mund të luajnë një rol të rëndësishëm në këtë drejtim. Megjithatë, edhe në qoftë se gjetja e instrumenteve të përbashkëta politike më të përshtatshme, mund të jetë e komplikuar, ekzistenca e dështimit të tregut ose objektivat politikë nuk mund të justifikojnë automatikisht përdorimin e ndihmës shtetërore.

Sipas PNP, ndotësi duhet të paguajë të gjitha kostot e ndotjes së tij, duke përfshirë kostot e tërthorta që përballohen nga shoqëria. Për këtë qëllim, legjislacioni i mjedisit mund të jetë një instrument i dobishëm që të rrisë barrën mbi ndotësin. Lidhja me PNP siguron, në teori, që dështimi i tregut, i lidhur me eksternalitetet negative, do të ndreqet. Rrjedhimisht, në qoftë se PNP do të zbatohet plotësisht, ndërhyrja e mëtejshme e shtetit nuk do të jetë e nevojshme për të pasur si rezultat një treg eficient. PNP mbetet rregull kryesor dhe ndihma shtetërore është në fakt një opsion i dytë i mirë. Përdorimi i ndihmës shtetërore në kontekstin e PNP-ve do të lehtësojë ndotësin nga barra e pagesës së kostos së ndotjes së tij. Prandaj, në raste të tilla, ndihma shtetërore nuk mund të jetë instrumenti i duhur.

Megjithatë, në veçanti, kur nuk kryhet zbatimi i plotë i PNP, pra kur niveli ekzistues i mbrojtjes së mjedisit konsiderohet i pakënaqshëm, mund të përdoret instrumenti i ndihmës shtetërore. Ajo mund të ofrojë stimul pozitiv për ndërmarrjet që të kryejnë veprimtari ose të bëjnë investime që nuk janë të detyrueshme dhe që, pa praninë e ndihmës shtetërore, nuk do të merreshin përsipër nga shoqëritë, të cilat kanë për qëllim fitimin.

1.2 Efekti nxitës dhe domosdoshmëria e ndihmës

Ndihma shtetërore për mbrojtjen e mjedisit duhet të çojë në ndryshimin e sjelljes së përfituesit të ndihmës, në mënyrë që niveli i mbrojtjes së mjedisit të jetë më i lartë sesa në rastin e mungesës së ndihmës shtetërore. Megjithatë, investimet të cilat rrisin nivelin e mbrojtjes së mjedisit në të njëjtën kohë mund të rrisin të ardhurat dhe/ose të ulin kostot dhe, kështu, të jenë ekonomikisht atraktive për vetë ndërmarrjen. Prandaj, duhet të vërtetohet nëse investimi në fjalë nuk do të ishte ndërmarrë në mungesë të ndihmës shtetërore.

Objektivi është që të sigurojë se ndërmarrjet, pa ndihmë, nuk do të angazhohen në të njëjtën veprimtari, për shkak të mungesës së përfitimeve prej saj. Analiza e këtij faktori është shumë e rëndësishme për të vlerësuar nëse ndihma shtetërore ka ose jo një efekt nxitës, si dhe për të llogaritur investimet ose kostot shtesë të prodhimit, të nevojshme për të arritur një nivel më të lartë të mbrojtjes së mjedisit.

Investimi mund të jetë i nevojshëm për të përmbushur standardet e detyrueshme mjedisore. Meqenëse ndërmarrja do të duhet të pajtohet me ato standarde në çdo rast, ndihma shtetërore për të përmbushur standardet e detyrueshme, që janë tashmë në fuqi, nuk mund të justifikohet.

1.3 Proporcionaliteti i ndihmës

Ndihma është konsideruar të jetë proporcionale vetëm nëse i njëjti rezultat nuk mund të arrihet pa ndihmën. Përveç kësaj, proporcionaliteti mund të varet nga shkalla e përzgjedhshmërisë së një mase.

Në veçanti, vlera e ndihmës duhet të jetë e kufizuar në minimumin e nevojshëm për të arritur mbrojtjen e kërkuar të mjedisit. Prandaj, kostot e pranueshme të ndihmës për investime janë bazuar në nocionin e kostove (neto) të nevojshme për të përmbushur objektivat mjedisore. Pra, në mënyrë që të përcaktohet se sa ndihmë mund të jepet, të gjitha përfitimet ekonomike që merr ndërmarrja nga investimi, në parim, duhet të zbriten nga kostot shtesë të investimeve.

Në mënyrë që ndihma të jetë proporcionale, Komisioni konsideron se vlera e ndihmës, normalisht, duhet të jetë më e vogël se kostot e pranueshme për investimin. Vetëm në rastet kur ndihma për investim është dhënë nëpërmjet një procesi të prokurimit publik, vërtet konkurrues dhe mbi bazën e kriterëve të qarta, transparente dhe jodiskriminuese - duke siguruar në mënyrë efektive që ndihma të jetë e kufizuar në minimumin e nevojshëm për të arritur përfitime mjedisore - shuma e ndihmës mund të arrijë 100% të kostos së pranueshme të investimeve. Në rrethana të tilla, mund të supozohet se ofertat përkatëse pasqyrojnë të gjitha përfitimet e mundshme që mund të vijnë nga investimet shtesë.

Për disa masa, të tilla si: ndihma për mjedisin në formën e përjashtimit ose uljes së taksave, proporcionaliteti duhet të sigurohet nëpërmjet kushteve dhe kriterëve për dhënie e përjashtimeve dhe uljes, që të sigurojë se përfituesi nuk merr përparësi të tepruar dhe se karakteri përzgjedhës i masës është i kufizuar në minimumin e mundshëm.

Për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, kostoja e arritjes së mbrojtjes së mjedisit shpesh është më e lartë, në terma relativë, krahasuar me madhësinë e veprimtarisë së tyre. Përveç kësaj, aftësia SME-ve për të përballuar shpenzime të tilla është, shpesh, e kufizuar nga papërsosmëria e tregut të kapitaleve. Për këtë arsye, si dhe për shkak të një rreziku më të vogël të shtrembërimeve serioze të konkurrencës kur përfituesi është ndërmarrje e vogël apo e mesme, për këto ndërmarrje, mund të përligjet një bonus për disa lloje të ndihmës.

Përveç kësaj, dhënësit e ndihmës duhet të sigurojnë efektshmërinë e kostove në arritjen e përfitimeve mjedisore, për shembull, duke propozuar plane ndihme, në të cilat kostot e jashtme të shmangura, zënë një peshë të rëndësishme krahasuar me vlerën e ndihmës. Sidoqoftë, kostot e jashtme mund të përdoren si bazë për të përcaktuar vlerën e ndihmës shtetërore vetëm në raste tepër të veçanta. Normalisht, në mënyrë që të sigurohet një nxitje e mjaftueshme për ndërmarrjet që të ndryshojnë sjelljen, vlerat e ndihmës duhet të jenë të lidhura drejtpërdrejt me koston që duhet të përballohet nga vetë ndërmarrja.

1.4 Kufizimi i efektit negativ të ndihmës së mjedisit, në mënyrë që bilanci i përgjithshëm të jetë pozitiv

Në qoftë se masat e ndihmës shtetërore për mjedisin janë të përcaktuara qartë, sidomos duke kundërpeshuar kostot aktuale shtesë të lidhura me një nivel më të lartë të mbrojtjes së mjedisit, rreziku që ndihma të shtrembërojë konkurrencën, përgjithësisht, është i kufizuar. Në rastet kur ndihma nuk është e nevojshme ose nuk është në përpjesëtim për atë që kërkohet për arritjen e një objektivi të caktuar, ajo është e dëmshme për konkurrencën. Veçanërisht të tilla janë rastet kur ndihma të çon në:

- a) mbajtjen në qarkullim të ndërmarrjeve joeficiente;
- b) shtrembërimin e incentivave për zhvillim dinamik / derdhja jashtë e mbeturinave;
- c) krijimin e fuqisë së tregut të ose të praktikave antikonkurruese/përjashtuese;
- d) ndryshimin artificial të këmbimeve tregtare apo të vendit të prodhimit.

Në disa raste, masat ndikojnë në funksionimin e tregut për të favorizuar, në dobi të përgjithshme të mjedisit, disa prodhime që përmbushin standardet mjedisore ndaj të tjerave, më tepër ndotëse. Si rezultat i masave të tilla, prodhuesit e produkteve ekologjike, në fjalë, do të jenë në gjendje të

përmirësojnë pozitën e tyre në treg, në raport me konkurrentët që ofrojnë produkte më të dëmshme për mjedisin. Në vlerësimin e këtyre rasteve, DNSH dhe KNSH do të marrin parasysh efektin e përgjithshëm mjedisor të masës, si dhe pozicionin në treg dhe, për rrjedhim edhe fitimet e ndërmarrjeve që nuk kanë përfituar prej saj. Sa më i vogël të jetë efekti i pritshëm mjedisor i masës në fjalë, aq më e rëndësishëm është verifikimi i ndikimeve që ajo mund të ketë në treg.

2. PËRKUFIZIME

Për qëllim të këtij udhëzimi, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. “Mbrojtje e mjedisit” është çdo veprim që synon parandalimin dhe kufizimin e dëmtimeve fizike nga veprimtaritë e përfituesit, për të zvogëluar rrezikun e një dëmtimi të tillë, ose që çon në përdorimin efikas të burimeve natyrore, duke përfshirë masat e kursimit të energjisë dhe përdorimin e burimeve të rinovueshme të energjisë.

2. “Burimet e rinovueshme të energjisë” janë burimet e rinovueshme, jofosile të energjisë, të tilla si: era, energjia diellore, burimet gjeotermale, valët, baticat, instalimet hidrike, biomasa, gazrat që çlirohen nga vendet e ruajtjes së mbeturinave, gazrat që çlirohen nga fabrikat e trajtimit të mbetjeve urbane, si dhe biogazet.

3. “Energjia nga burimet e rinovueshme” është energjia e prodhuar nga impiante që përdorin vetëm burimet e energjisë së rinovueshme, si edhe pjesa, në termat e fuqisë kalorifike, të energjisë së prodhuar nga burimet e energjisë së rinovueshme në impiantet hibride, të cilat përdorin edhe burime konvencionale të energjisë. Ajo përfshin energjinë elektrike të rinovueshme, të përdorur për mbushjen e sistemeve të magazinimit, por përjashton energjinë elektrike, të prodhuar si rezultat i sistemeve të ruajtjes.

4. “Bashkëgjenerim” është prodhimi i kombinuar e me efikasitet të lartë i energjisë dhe nxehtësisë/gjenerimi i njëhershëm nga një proces i vetëm i energjisë termike dhe energjisë elektrike dhe/ose mekanike.

5. “Zonë e ndotur” është vendi ku vërtetohet prania e lëndëve të rrezikshme, të shkaktuara nga njeriu, në një nivel të tillë që, për shkak të përdorimit të tokës në të tashmen apo në të ardhmen, përbën një rrezik të madh për shëndetin e njeriut apo mjedisin.

6. “Ndotës” është kushdo që, drejtpërdrejt ose tërthorazi, dëmton mjedisin apo krijon kushte që çojnë në dëme të tilla.

7. “Parimi ndotësi paguan” do të thotë se shpenzimet për ndotjen duhet të përballohen nga ndotësi që shkakton ndotjen, përveç rasteve kur shkaktori i ndotjes nuk mund të identifikohet apo nuk mund të jetë përgjegjës sipas legjislacionit në fuqi. Në këtë rast, ndotja është dëmi i shkaktuar nga ndotësi, drejtpërdrejt ose tërthorazi, duke dëmtuar mjedisin ose duke krijuar kushte të përshtatshme për krijimin e dëmeve të tilla, në mjedisin rrethues apo në burimet natyrore.

8. “Mbetje” janë lëndët, objektet ose pjesë të tyre, që përcaktohen nga autoriteti përgjegjës, të cilat nuk përdoren më ose që pronari do t'i largojë. Mbetjet vlerësohen si të tilla, për sa kohë që materialet e nxjerra prej tyre ose energjia e prodhuar nuk përfshihet në procesin e prodhimit.

9. “Ndërmarrje” është çdo person fizik ose juridik, privat ose publik, që kryen veprimtari ekonomike.

3. NDIHMA SHKETËRORE PËR MBROJTJEN E MJEDISIT

Neni 13/1 i ligjit përcakton se ndihma për mbrojtjen e mjedisit mund të jepet vetëm për:

1. investim për nxitjen e energjisë nga burime të rinovueshme të energjisë;
2. investim për menaxhimin e mbetjeve të ndërmarrjeve të tjera, përfshirë këtu ripërdorimin, riciklimin dhe kthimin;
3. investim për ndërmarrjet, që merren me riparimin e dëmeve mjedisore, duke rehabilituar zonat e ndotura;
4. investim për prodhimin e kombinuar e me efikasitet të lartë të energjisë dhe nxehtësisë.

3.1 Ndhimja për burimet e rinovueshme të energjisë

Investimet për mjedisin dhe ndihma për nxitjen e prodhimit të energjisë nga burime të rinovueshme është në përputhje me nenin 13/1 shkronja “a” të ligjit, nëse përmbushen kushtet e parashikuara në të. Kjo lloj ndihme adreson dështimin e tregut të lidhur me eksternalitetet negative, duke krijuar stimuj të veçantë për të rritur pjesën e energjisë së prodhuar nga burimet e rinovueshme, kundrejt totalit të prodhimit të saj. Rritja e përdorimit të burimeve të energjisë së rinovueshme është një nga prioritetet mjedisore, që pritet të luajë një rol të rëndësishëm në përmbushjen e objektivave për

zvogëlimin e emetimeve të gazrave që shkaktojnë “efektin serë”. Ndhimja për investim dhe/ose operacionale për prodhimin e biokarburanteve lejohet vetëm për biokarburantet e qëndrueshme.

3.1.1 Intensiteti i ndihmës

Intensiteti i ndihmës nuk duhet të tejkalojë 45% të kostos së pranueshme për investime.

Nëse ndihimja për investim për burimet e rinovueshme të energjisë i jepet ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, intensiteti i ndihmës mund të rritet me 10 për qind për ndërmarrjet e mesme dhe 20 për qind për ndërmarrjet e vogla, siç është përcaktuar në tabelë.

Ndërmarrjet	Intensiteti i ndihmës për burimet e rinovueshme të energjisë
E vogla	65%
Të mesme	55%
Të mëdha	45%

3.1.2 Kostot e pranueshme

Kostot e pranueshme të investimit për energjinë e rinovueshme, duhet të jenë të kufizuara deri në koston shtesë të investimeve, që duhet të përballohet nga përfituesi, krahasuar me një impiant konvencional ose me një sistem tradicional ngrohjeje me kapacitet të njëjtë, në kushtet e prodhimit efektiv të energjisë.

Kostot e pranueshme duhet të llogariten neto nga çdo përfitim operacional dhe nga kostot operacionale, që lidhen me investimet shtesë për burimet e rinovueshme të energjisë dhe që krijohen gjatë pesë viteve të para të investimit.

3.2 Ndhimja për menaxhimin e mbetjeve

Ndhimja për investime në mjedis për menaxhimin e mbetjeve të ndërmarrjeve të tjera, duke përfshirë veprimtarinë e ripërdorimit, riciklimit dhe përpunimit, do të konsiderohet në përputhje me nenin 13/1 shkronja “b” të ligjit, me kusht që kjo veprimtari të jetë në përputhje me klasifikimin hierarkik të parimeve të menaxhimit të mbetjeve. Kjo ndihmë ka për qëllim të japë stimuj individualë për të arritur objektivat mjedisore të lidhura me menaxhimin e mbetjeve. Objektivi parësor është të bëjë ndarjen e gjenerimit të mbetjeve nga veprimtaritë ekonomike, në mënyrë që procesi i zhvillimit ekonomik të vendit të mos shoqërohet me shtimin e mëtejshëm të mbetjeve.

Në këto kushte, ndihimja për investim për menaxhimin e mbetjeve të ndërmarrjeve të tjera, duke përfshirë ripërdorimin, riciklimin dhe kthimin, jepet nëse përmbushet secili nga kushtet e mëposhtme:

- i) Investimi ka për qëllim zvogëlimin e ndotjes së prodhuar nga ndërmarrjet e tjera (ndotësit) dhe nuk shtrihet në ndotjen e krijuar nga përfituesit e ndihmës.
- ii) Ndhimja nuk e çliron ndotësin, në mënyrë të tërthortë, nga një barrë që ai duhet të mbulojë në zbatim të ligjit ose nga një barrë që duhet të konsiderohet si një kosto normale e ndërmarrjes për ndotësit.
- iii) Investimi shkon përtej “situatës aktuale” ose nëse përdor teknologjitë konvencionale në mënyrë novatore.
- iv) Materialet e trajtuara, në rast se nuk kryhet investimi, do të depozitohen ose do të trajtohen në një mënyrë më pak miqësore me mjedisin.
- v) Investimi nuk çon në rritjen e kërkesës për riciklimin e materialeve, pa rritur më parë kërkesën për grumbullimin e këtyre materialeve.

3.2.1 Intensiteti i ndihmës

Intensiteti i ndihmës nuk duhet të tejkalojë 50% të kostos së pranueshme për investim.

Nëse ndihimja për investim për administrimin e mbeturinave i jepet ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, intensiteti i ndihmës mund të rritet me 10 për qind për ndërmarrjet e mesme dhe me 20 për qind për ndërmarrjet e vogla, siç përcaktohet në tabelë.

Ndërmarrjet	Intensiteti i ndihmës për administrimin e mbetjeve
E vogla	70 %
Të mesme	60 %
Të mëdha	50 %

3.2.2 Kostot e pranueshme

Kostot e pranueshme duhet të kufizohen vetëm në kostot shtesë të investimeve, të nevojshme për të realizuar një investim që sjell menaxhimin e mbetjeve dhe që përballohen nga përfituesi, në krahasim me investimet e referencës, pra me një prodhim konvencional, me kapacitet të njëjtë, i cili nuk përfshin administrimin e mbetjeve. Kostoja e një investimi të tillë reference duhet të zbritet nga kostot e pranueshme.

Edhe në këtë rast, kostot e pranueshme duhet të llogariten neto nga çdo përfitim operacional dhe nga kostot operationale, që lidhen me investimet shtesë dhe që krijohen gjatë pesë viteve të para të këtij investimi.

3.3 Ndhimja për rehabilitimin e zonave të ndotura

Ndhimja për investim që u jepet ndërmarrjeve për riparimin e dëmit mjedisor, duke rehabilituar vendet e ndotura, do të konsiderohet në përputhje me nenin 13/1 shkronja "c" të ligjit, me kusht që të sjellë përmirësim të mbrojtjes së mjedisit. Dëmtimi i mjedisit mbulon dëmtimin e cilësisë së tokës ose të ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore. Kjo lloj ndihme synon të krijojë një nxitje individuale për të balancuar efektet e eksternaliteteve negative, dhe kur nuk është e mundur, të identifikojnë ndotësin dhe ta detyrojë atë të paguajë për riparimin e dëmit mjedisor që ka shkaktuar. Në raste të tilla, ndihma shtetërore mund të justifikohet nëse kostoja e rehabilitimit është më e lartë sesa rritja e vlerës së zonës së ndotur.

Nëse ndotësi është identifikuar në mënyrë të qartë, atëherë ai duhet të financojë rehabilitimin në përputhje me parimin "ndotësi paguan" dhe nuk mund të përfitojë asnjë ndihmë shtetërore.

Personi përgjegjës për punën mund të përfitojë ndihmë, nëse ndotësi nuk është identifikuar ose nuk është në gjendje të përballojë shpenzimet.

3.3.1 Intensiteti i ndihmës

Ndhimja për rehabilitimin e vendeve të ndotura mund të arrijë deri në 100% të kostove të pranueshme. Shuma totale e ndihmës, në asnjë rrethanë, nuk mund të tejkalojë shpenzimet aktuale të ndërmarrjes.

3.3.2 Kostot e pranueshme

Kostot e pranueshme janë të barabarta me kostot për punën rregulluese, duke u zbritur rritjen e vlerës së tokës. Të gjitha shpenzimet e kryera nga ndërmarrja për rehabilitimin e tokës, nëse ato mund të pasqyrohen si asetë fikse në bilanc, do të klasifikohen si investime të pranueshme, në rastin e rehabilitimit të vendeve të ndotura.

3.4 Ndhimja për prodhimin e kombinuar e me efikasitet të lartë të energjisë dhe nxehtësisë

Kjo ndihmë e lidh dështimin e tregut me eksternalitetet negative, duke krijuar stimuj të veçantë për të përmbushur objektivat mjedisore për sa i takon kursimit të energjisë.

Ndhimja për investimet mjedisore dhe ndihma operationale për prodhimin e kombinuar e me efikasitet të lartë të energjisë dhe nxehtësisë, do të konsiderohet në përputhje me nenin 13/1, shkronja "d" të ligjit, me kusht që:

a) njësia e re, e ngritur për prodhimin e kombinuar e me efikasitet të lartë të energjisë dhe nxehtësisë, do të sjellë kursimin me përparësi të energjisë, krahasuar me prodhimin prej njësisive të veçanta;

b) përmirësimi i një njësie ekzistuese prodhimi të kombinuar e me efikasitet të lartë të energjisë dhe nxehtësisë ose konvertimi i një njësie gjeneruese energjie ekzistuese në një njësi prodhimi të kombinuar e me efikasitet të lartë të energjisë dhe nxehtësisë sjell kursimin e energjisë krahasuar me gjendjen fillestare.

3.4.1 Intensiteti i ndihmës

Intensiteti i ndihmës nuk duhet të tejkalojë 45% të kostos së pranueshme për investime.

Nëse ndihimja për investim për prodhimin e kombinuar e me efikasitet të lartë të energjisë dhe nxehtësisë do jepet për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, intensiteti i ndihmës mund të rritet me 10 për qind, për ndërmarrjet e mesme dhe me 20 për qind për ndërmarrjet e vogla, siç përcaktohet në tabelë.

Ndërmarrjet	Intensiteti i ndihmës për prodhimin e kombinuar të energjisë
E vogla	65%
Të mesme	55%
Të mëdha	45%

3.4.2 Kostot e pranueshme

Kostot e pranueshme duhet të kufizohen deri në koston shtesë të investimeve të nevojshme, për të realizuar një prodhim të kombinuar e me efikasitet të lartë të energjisë dhe nxehtësisë, me efikasitet të lartë, krahasuar me një investim reference.

Kostot e pranueshme duhet të llogariten si neto prej çdo përfitimi operacional dhe kostove operationale të lidhura me investimet shtesë dhe që lindin gjatë pesë viteve të para të këtij investimi.

3.4.3 Ndhimja operationale

Ndhimja operationale mund të jepet për prodhimin e kombinuar e me efikasitet të lartë të energjisë dhe nxehtësisë, në bazë të rregullave për ndihmën operationale, të përcaktuara në nenin 7 të rregullores “Për kushtet dhe procedurat e dhënies së ndihmës rajonale”. Ajo mund të jepet:

a) Për ndërmarrjet që shpërndajnë njëkohësisht energji elektrike dhe ngrohje për publikun, ku kostoja për prodhimin e energjisë elektrike ose ngrohjes tejkalon çmimin e tregut. Vendimi për të përcaktuar nëse ndihma është e nevojshme, do të bazohet në shpenzimet dhe të ardhurat, që rezultojnë nga prodhimi dhe shitja e energjisë elektrike ose ngrohjes.

b) Për përdorim industrial të prodhimit të kombinuar të energjisë elektrike dhe ngrohjes, ku kostoja e prodhimit të një njësie të energjisë, duke përdorur këto teknika, tejkalon çmimin e tregut për një njësi të energjisë konvencionale. Kostoja e prodhimit mund të përfshijë normën e kthimit të kapitalit, por, në këtë rast, çdo fitim i ndërmarrjes nga prodhimi i nxehtësisë, duhet të zbritet nga shpenzimet totale të prodhimit.

Nëse ndihma për investim jepet nëpërmjet një procesi konkurrues tenderi mbi bazën e kriterëve të qarta, transparente dhe jodiskriminuese, duke siguruar në mënyrë efektive që ndihma të jetë e kufizuar në minimumin e nevojshëm për shpërndarjen maksimale të energjisë së rinovueshme për nxitjen e energjisë nga burime të rinovueshme të energjisë, ose në minimumin e nevojshëm për arritjen e kursimit maksimal të energjisë për ndihmën shtetërore për prodhimin e kombinuar e me efikasitet të lartë të energjisë dhe nxehtësisë, intensiteti i ndihmës mund të arrijë deri në 100% të koston së pranueshme të investimeve.

Procesi i tenderit duhet të jetë jodiskriminues dhe të sigurojë pjesëmarrjen e një numri të mjaftueshëm ndërmarrjesh. Buxheti, që lidhet me procesin e tenderit duhet të jetë detyrues dhe i përcaktuar, në kuptimin që jo të gjithë pjesëmarrësit mund të përfitojnë ndihmë dhe ndihma duhet të jepet në bazë të ofertës fillestare të paraqitur nga ofertuesit, duke përjashtuar negociatat pasuese.

VENDIM

Nr.33, datë 15.2.2010

PËR SKEMËN EKZISTUESE TË SUBVENCIONIMIT TË HEKURUDHAVE

Komisioni i Ndhmës Shtetërore, me pjesëmarrjen e:

- | | |
|--------------------|-----------|
| Z. Dritan Prifti | - Kryetar |
| Znj. Mimoza Dhëmbi | - Anëtare |
| Z. Arben Ndoci | - Anëtar |
| Z. Gjergj Thomai | - Anëtar |
| Z. Zef Preçi | - Anëtar |

Në mbledhjen e tij të datës 15.2.2010, shqyrtoi raportin “Për disa skema ekzistuese të ndihmës, që duhet të sigurojnë përputhjen e plotë me legjislacionin europian”, të përgatitur nga Drejtoria e Ndhmës Shtetërore në Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.

BAZA LIGJORE: Si bazë ligjore për skemën është vendimi i Këshillit të Ministrave nr.45, datë 16.1.2008 “Për miratimin e raportit “Për inventarin e skemave ekzistuese të ndihmës shtetërore në Shqipëri” dhe vendimi i Komisionit të Ndhmës Shtetërore nr.8, datë 2.2.2007 dhe nr.15, datë 15.3.2007 “Për skemën ekzistuese të subvencionimit të hekurudhave”.

Komisioni i Ndhmës Shtetërore, pasi shqyrtoi raportin e përgatitur nga Drejtorja e Ndhmës Shtetërore,

VËREN SE:

1. Ndërmjet MPPTT-së dhe HSH-së është nënshkruar kontrata për detyrimin e ofrimit të shërbimit publik për transportin hekurudhor të udhëtarëve dhe mbështetjen financiare nga ana e shtetit.
2. Edhe pse në parim janë bërë llogaritjet për subvencionimin e drejtpërdrejtë për të mbuluar koston e plotë të shërbimeve të transportit publik, rezultati financiar ka qenë negativ.
3. Nga ana e MPPTT-së, ende nuk është paraqitur një plan i plotë për zhvillimin e këtij sektori dhe vendin që ai do të zërë midis rrugëve të tjera të transportit.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Ndhmës Shtetërore, mbështetur në nenin 23 të ligjit nr.9374, datë 21.2.2005 “Për ndihmën shtetërore”, si dhe në nenin 19 të rregullores “Për procedurat dhe formën e njoftimit”, miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.817, datë 28.12.2005,

VENDOSI:

1. Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit të përgatisë një plan të ristrukturimit të sektorit hekurudhor, ku të ketë përcaktuar masat që do t'i kthejnë rentabilitetin këtij sektori dhe afatet përkatëse.
2. Plani i ristrukturimit të dorëzohet në Drejtorinë e Ndhmës Shtetërore brenda datës 30 shtator 2010, për t'u vlerësuar dhe për të marrë miratimin nga Komisioni i Ndhmës Shtetërore.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETAR
Dritan Prifti**

VENDIM Nr.16, datë 25.2.2010

PËR MIRATIMIN E RAPORTIT VJETOR TË ERE-S “GJENDJA E SEKTORIT TË ENERGJISË DHE VEPRIMTARIA E ERE-S GJATË VITIT 2009”

Në zbatim të neneve 9 dhe 10 pika 1 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, dhe ligjit nr.9946, datë 30.6.2008 “Për sektorin e gazit natyror”, neni 13, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë, në mbledhjen e tij të datës 25.2.2010, pasi shqyrtoi raportin vjetor të ERE-s “Gjendja e sektorit të energjisë dhe veprimtaria e ERE-s gjatë vitit 2009”, të paraqitur nga kryetari i ERE-s,

VENDOSI:

1. Miratimin e raportit vjetor të ERE-s “Gjendja e sektorit të energjisë dhe veprimtaria e ERE-s gjatë vitit 2009”, që do t'i paraqitet Kuvendit të Shqipërisë (raporti bashkëlidhur këtij vendimi).
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI I ERE-S
Bujar Nepravishta**

VENDIM
Nr.17, datë 25.2.2010

**PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE TË RISHIKIMIT TË RREGULLORES SË PROCEDURAVE
TË CERTIFIKIMIT TË PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA BURIMET E
RINOVUESHME**

Në mbështetje të neneve 8, pika 2 germa “m”, dhe 9 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, dhe nenit 26 pika 2 të rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.21, datë 18.3.2009, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë, në mbledhjen e tij të datës 25.2.2010, pasi shqyrtoi propozimin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, për rishikimin e rregullores së procedurave të certifikimit të prodhimit të energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurat për rishikimin e rregullores së procedurave të certifikimit të prodhimit të energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtoria Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit për përpunimin e ndryshimeve në rregulloren e procedurave të certifikimit të prodhimit të energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Bujar Nepravishta

VENDIM
Nr.18, datë 26.2.2010

**PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “DOSKU-ENERGY”
SHPK**

Në mbështetje të neneve 8, pika 2 germa “a”, 9 dhe 13, pika 1 germa “a” të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, neneve 4 pika 1 germa “a”, 8 pika 4 dhe 10 pikat 1 dhe 3 të “Rregullores për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.108, datë 9.9.2008, nenit 18, pika 1 germa “a”, të rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.21, datë 18.3.2009, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 26.2.2010, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Dosku-Energy” sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit mbi licencimin në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike të kësaj shoqërie,

konstatoi se:

- Aplikimi i shoqërisë “Dosku-Energy” sh.p.k., plotëson kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave, si më poshtë:

- Formatin e aplikimit (neni 9, pika 1 germat “a”, “b” dhe “c”) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2 germat “a”, “b”, “c”, “d”, “f” dhe “g”), është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte (në kontratën koncesionare përcaktohet se organi shtetëror i autorizuar merr përsipër të kryejë procedurën e shpronësimit sipas legjislacionit në fuqi, pas paraqitjes së dokumentacionit të nevojshëm për shpronësim nga koncesionari).

- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3 germet “a”, “b” dhe “d”) janë paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni teknik (neni 9, pika 4) është plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurat për licencimin e shoqërisë “Dosku-Energy” sh.p.k., në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga hidrocentrali “Gizavesh”.

2. Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut ta njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S

Bujar Nepravishta

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi "Gjergj Fishta", mbrapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", tel: 04 24 27 003.

Çmimi i abonimit në postë për Fletoret Zyrtare 2010 është 16 000 lekë.

Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

KODI I PROCEDURËS CIVILE	240 lekë
KODI PENAL	226 lekë
KODI I PROCEDURËS PENALE.....	330 lekë
KODI CIVIL	410 lekë
KODI I PUNËS	140 lekë
KODI PENAL USHTARAK	55 lekë
KODI I FAMILJES	270 lekë
KUSHTETUTA	95 lekë
KODI I PROCEDURËS ADMINISTRATIVE	90 lekë
PËRMBLEDHËSE PËR KTHIMIN DHE KOMPENSIMIN E PRONAVE	140 lekë

Hyri në shtyp më 17.3.2010

Doli nga shtypi më 19.3.2010

Tirazhi: 3000 copë

Formati: 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2010

Çmimi 32 lekë